



MSc. Marsida Bushati

Znj. Marsida Bushati ka kryer studimet e larta në Universitetin e Sporteve të Tiranës në vitet (2006 – 2010) ku është diplomuar si studente e ekselencës. Për tre vite ka kryer studime Universitare (2011 – 2014) në degën e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës.

Në shtator të 2010 u emërua si inspektore sportesh pranë Klubit të Shumë Sporteve Teuta, ku vijoi deri në vitin 2019. Në vitin 2013 filloi punë si pedagoge part – time në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, ku vijoi deri në vitin 2019. Që nga viti 2013 e në vazhdim Znj. Bushati ka kontribuar në mësimdhënie duke hartuar programin e lëndës së Atletikës Rekreative në Departamentin e Veprimtarisë Fizike Rekreative dhe Turizmit.

Në vitin 2018 Znj. Bushati është angazhuar si specialiste dhe këshilluese për hartimin e silabuseve ,kurrikulës dhe planit mësimor në Bachelor dhe Master Profesional pranë Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve, Fakultetit të Shkencave Humane Edukimit dhe Arteve Liberale , Universiteti European i Tiranës.

Nga viti 2019 e në vazhdim Znj. Bushati ka zhvilluar veprimtarinë e saj universitare si personel akademik me drejtim kërkimor në Institutin e Kërkimit Shkencor të Sportit, pranë Universitetit të Sporteve të Tiranës. Ajo është angazhuar në procesin mësimorë dhe kërkimorë në fushën e performancës sportive.

Znj. Bushati ka një karrierë të gjatë sportive si atlete profesioniste ku është shpallur për shumë vite kampione kombëtare në disiplinën e kërcimit së gjati dhe të kërcimit 3-hapësh, ku ka thyer edhe rekordin kombëtarë të U 18. Në vitin 2007 ka marrë medalje bronzi në Ballkanjadën për të rinj e shumë vënde nderi nëpër takime miqësore ndërkombëtare.

Znj. Bushati është autore e botimeve të shumta shkencore në periodikë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, pjesëmarrëse me referime kryesore në një sërë aktiviteteve shkencore kombëtare e ndërkombëtare.